

DEKLARATË

Ne, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të angazhuar në mbrojtje të të drejtave të njeriut, fuqizimin e shtetit të së drejtës dhe interesat legjitime të shtetasve, shprehim shqetësimin tonë për ecurinë e ngadaltë të zbatimit të reformës të dakordësuar mes të gjithë deputetëve më 22 korrik 2016. Tashmë që Komisioni i Venecias u shpreh zyrtarisht mbi pyetjet e adresuara, Gjykata Kushtetuese duhet ta shqyrtojë me përparësi çështjen e Ligjit të Vetingut! Përveç realizimit të interesit qytetar, zbatimi i kësaj reforme është parakusht për të ardhmen tonë në Bashkimin Evropian.

Ne jemi të vetëdijshëm që çdo ankesë kushtetuese meriton një shqyrtim të paanshëm juridik në Gjykatën Kushtetuese, por njëkohësisht çojmë se në këtë rast Gjykata duhet të vendosë sa më shpejt.

Duke besuar që Gjykata Kushtetuese do të vlerësojë me përgjegjshmëri të lartë opinionin e Komisionit të Venecias, si autoriteti më i urtë dhe i gjithëpranuar, ne do të ndjekim me vëmendje çdo hap të shqyrtimit të kësaj çështjeje, si dhe të zbatimit të reformës në tërësi, për të siguruar mbrojtjen e interesave të qytetarëve!

Qytetarët shqiptarë e duan reformën në drejtësi. Nuk ka më kohë për të humbur!

KOALICIONI "DREJTËSI PËR TË GJITHË", PËRFAQËSUAR NGA:

1. Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale – ALTRI
2. Shërbimi Ligjor Falas Tiranë – TLAS
3. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri – AWEN
4. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
5. Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem
6. Qendra Aleanca Gjinore pr Zhillim, Tiranë
7. Jona – Sarandë
8. Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
9. Shoqata "Unë Gruaja" Pogradec.
10. Forumi Gruas – Elbasan
11. Shoqata "Agritra Vizion" – Peshkopi
12. Shoqata "Gruaja tek Gruaja", - Shkodër
13. Zyra për Burra dhe Djem, - Shkodër
14. Qendra Psiko-Sociale "Vatra", Vlorë
15. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara – ADRF
16. Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Anti-Trafikim – KKSAT
17. Balkan Youth Link Albania – BYL-A
18. Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri – IRCA
19. Rrjeti i Grave për Demokraci – WDN AI
20. Fondacioni: Qendra Rajonale "Syri i Medias së Re", Gjirokastër
21. Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara
22. Qendra "Res Publica"
23. Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri – AmCham

24. Shoqata "Tjetër Vizion", Elbasan
25. Organizata "Të ndryshëm dhe të Barabartë"
26. Qendra Evropiane
27. Shoqata "Together for Life"

SI DHE ORGANIZATA TË TJERA TË SHOQËRISË CIVILE, SI MË POSHTË:

1. Civil Rights Defenders
2. Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome
3. Organizata Ushten
4. Albanian Innovation Accelerator – AIA
5. Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile Durrës – CSDC
6. Instituti i Evropës Juglindore për Kontratën Sociale – SSCI
7. Zëri i Integritimit
8. Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike – ANTTARC
9. Instituti për Promovimin e Zhvillimit Social Ekonomik – IPSED
10. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim – IDN
11. Instituti Shqiptar për Zhvillim Politikash
12. INFOCIP
13. Instituti për Demokraci dhe Zhvillim
14. Gruaja dhe Media